



BULETINI MUJOR I SEMUNDSHMERISE INFEKTIVE

(Pasqyra 14 Sh)

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

PRILL, 2019

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 të çdo muaji. Të dhënat e agreguara të pasqyrës 14 sh për muajin prill janë të dhënat e raportuara nga të 36 rrethet e vendit.

1. Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjate muajit prill 2019 zënë 28.17 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me ane të Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidencë 180.78/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohe që në nivel kombëtar toksikoinfeksionet alimentare paraqesin një incidencë 2.46/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Kukës dhe Kavajë mbajnë peshën kryesore në raportimin e toksikoinfeksioneve alimentare. Duhet theksuar që numri i lartë i rasteve të raportuara me toksikoinfeksione alimentare dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rrethëve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Rrethi i Shkodrës vazhdon të mbajë peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës jotifoide për muajin mars me 11 raste (0.66/10.000 banore) të konfirmuara. Janë raportuar 23 raste me Shigelozë, përkatësisht 21 raste (1.26/10.000 banore) nga rrethi Shkodër, 1 rast i dyshuar nga rrethi Dibër dhe një rast i dyshuar nga rrethi Kukës.

Gjate muajit prill është raportuar nga rrethi i Durrësit një rast me diagnozë Tifo abdominale, femër 22 vjeç e shtruar dhe e konfirmuar në Spitalin Rajonal Durrës, Reparti i Infektivit. Shërbimi i epidemiologjisë Durrës ka marrë të gjitha masat përkatëse.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin Prill, 2019

(Incidenca raste/100.000 banore)


	Raste, Prill 2019	Incidenca Prill 2019 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	1	0.04
Salmoneloza	11	0.39

Shigeloze (Disenteri bacilare)	23	0.82
Dizenteri amebike	0	0
Toksikoinfeksione alimentare	69	2.46
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	4958	177.06
Semundje diarreike ne total	5062	180.78


2. Sëmundjet e EPI

2.1. Fruthi

Gjatë muajit prill 2019 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë dyshuar në total 160 raste prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv 70 raste. Nga këto 35 raste (50%) e rasteve i përkasin rrethit të Tiranës. 34.3 % e rasteve të konfirmuara i përkasin kryesisht grupmoshës < 2 vjeç (24 raste) . Gjatë muajit prill vërehet një rënie e rasteve me Fruth. Një informacion më të zgjeruar ju mund ta gjeni në “Buletinin Javor të Fruthit”, në website e ISHP.



Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, Prill 2019



Grafiku 2. Kurba epidemike e rasteve te dyshuara për fruth sipas datës se fillimit te rashit, Prill 2018

Ne muajin Prill te nje viti me pare, 2018 u raportuan ne total 705 raste prej te vileve 324 u konfirmuan nga ana laboratorike . Nga keto 200 raste ose 62% i perkisnin rrethit te Tiranës. 23.5% ose 76 raste i perkisnin grupmoshes nen 2 vjec dhe 62 raste ose 19 % i perkasin grupmoshes 16-20 vjec.

Siç shihet ne krahasim për te njëjtën periudhë me një vit me pare, numri i rasteve është ne rënie dhe grupmoshat < 2 vjeç vazhdon te jete grupmosha me e prekur. Kjo për shkak edhe te mosvaksinimit dhe kontaktit apo vizitës te mëparshëm te tyre ne shërbimin pediatrik QSUT.

Te gjitha rastet janë konfirmuar ne Laboratorin e Virologjisë, ne ISHP.

2.2. Tuberkulozi pulmonar


Gjatë muajit prill 2019 janë raportuar 29 raste te reja me TB. Incidenca e TB 1.01 /100.000 banore. Nga rastet e konfirmuara me TB rezulton se 21 raste (72%) jane TB pulmonar dhe 8 raste ose (28%) te formës ekstrapulmonare. Rastet me TB pulmonar te konfirmuar bakteriologjikisht janë 11 raste me sputum pozitiv. 15 raste rezultojnë me sputum negativ dhe 4 raste nuk kane rezultat mikrobiologjik

Rastet pulmonare sputum pozitiv janë ne rrethet :6 raste ne Tirane, 2 raste sputum pozitiv ne Lushnja , 1 rast ne Lezhe dhe 1 raste ne Korçe, 1 rast ne spitalin e Burgut Tirane .

Rastet TB ekstrapulmonare jane 8 dhe përkatësisht 2 raste ne Tirane , nga 1 rast ne Berat, 1 rast ne Shkodër, 1 rast ne Elbasan, 2 raste ne Kukës, 1 rast ne Pogradec .

Format ekstrapulmonare janë : 6 raste versamnete pleurale TB, 1 rast limfoadenit TB, 1 rast perikardit TB.

Mosha mesatare e rasteve me TB është 44.6 vjeç (min 22 vjeç – max 89 vjeç) .



Shqetësuese ne raste TB mbeten grupmoshat 25-34 dhe 35-44 ku nr i rasteve është me i larte


Raste dominojnë te jene ne moshat e reja. Persa i përket gjinisë raporti M; F 2:1. Rastet me TB te konfirmuar ne Spitalin Universitar “ Shefqet Ndroqi” janë 14 raste ose 48 % dhe 15 raste ose 52 % e rasteve janë konfirmuar nga dispanseritë

Vihet re se konfirmimi i rasteve me TB nga dispanseritë ne muajin prill është rritur krahasuar me muajin mars ku nr i rasteve te konfirmuar nga dispanseritë ishte 48 % . Rastet me TB te shtruar ne këtë spital janë testuar dhe për sëmundjen e HIV.

Nga zonat urbane jane 19 raste TB ose (65%) dhe 10 raste me TB ose (35 %) janë nga zonat rurale

Krahasuar me muajin mars vihet te re një rritje e lehte e numrit te rasteve me TB nga 26 ne muajin mars ne 29 raste ne muajin prill.

Shpërndarja e rasteve me TB sipas rretheve për muajin prill 2019.



3. Zoonozat

Gjatë muajit prill me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh janë raportuar në nivel vendi pesë raste me bruceloze dhe vetëm një rast është i konfirmuar. Rastet janë raportuar nga rrethi Gjirokastrë (2 raste) dhe përkatësisht nga një rast Dibër, Korçë dhe Librazhd.

Gjatë muajit prill janë raportuar: një rast i konfirmuar me antraks nga Saranda, mashkull i grup-moshës 30-34 vjeç dhe një rast i dyshuar përkatësisht nga Tirana, mashkull i grup-moshës 50-54 vjeç.

Gjatë muajit prill janë raportuar dy raste të konfirmuara me Leishmaniaze kutane nga Lushnja, një mashkull i grup-moshës 5-9 vjeç dhe një femër e grup-moshës 30-34 vjeç.

**Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike në Prill 2019
(Incidencia raste/100.000 banorë)**

	Raste, Prill 2019	Incidencia Prill 2019 (raste/100.000 banorë)
Antraks (Plasje)	2	0.07
Brucelozë	5	0.18
Leptospirozë	0	0
Leishmaniaza viscerale	0	0
Leishmaniaza kutane	2	0.07

4. Hepatitet virale

Ne raportimin mujor te sëmundshmërisë infektive gjate muajit prill 2019 janë raportuar ne total 14 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.50/100.000 banore) nga te cilat 5 raste janë Hepatite virale të paspecifikuar, 7 raste Hepatit virale B te konfirmuara dhe 2 raste te dyshuara me Hepatit viral as A as B.

Ne lidhje me HBV, 7 rastet e konfirmuara janë raportuar përkatësisht nga rrethi Tirane (0.02/10.000 banore), Korçe (0.08/10.000 banore), Kruje (0.17/10.000 banore), Kuçove (0.37/10.000 banore), Lushnjë (0.08/10.000 banore) dhe Mat (0.23/10.000 banore).

Rastet me Hepatit viral B i përkasin grupmoshës se rritur përkatësisht nga 2 raste grupmosha 25-29 vjeç, përkatësisht nga 1 rast grupmosha 40-44 vjeç, 45-49 vjeç, 50-54 vjeç, 60-64 vjeç dhe 65 + vjeç.

Ne lidhje me Hepatitin C janë dy raste te reja te konfirmuara, meshkuj, grupmosha 35-39 vjeç dhe 40-44 vjeç nga Lushnja.

Duhet te theksojmë qe laboratorët nuk raportojnë ne lidhje me testimet për Hepatitin B.

5. HIV/AIDS

Gjatë muajit Prill 2019 janë kryer 47 ekzaminime me testin ELISA HIV 1+2 Ag/Ab ne “Laboratorin e Referencës se HIV/AIDS”, ISHP. Nga këto teste, 2 prej tyre kanë rezultuar HIV pozitive.

Rastet pozitive janë referuar nga Spitali i Burgut dhe Shërbimi i Toksikologjisë, QSUT. Dy rastet pozitive janë meshkuj me vendbanim ne Tirane dhe janë përkatësisht 32 vjeç dhe 24 vjeç.

INSTITUTI I
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI

